



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:004349

Datë: 28.07.2022

Numri i dokumentit: 03274122

C.nr.13/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, në çështjen juridike të paditësit Sh. K. nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson i autorizuari av.D. M. nga Prizreni, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve – BKS- me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 €uro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **28.07.2022** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit Sh. K. nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi Sh. K. nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit av.D. M. nga Prizreni pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve – BKS- me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.13/2021 të datës 05.05.2022 e ka ftuar paditësin që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguaj taksën e paraparë gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datën 12.05.2022 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas Nenit 253 par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e kësaj takse brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e së njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtueshmëri me nenin 253.5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.13/2021, me datë 28.07.2022.

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:004349
Datë: 28.07.2022
Numri i dokumentit: 03274122